




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 3, datë 23.02.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”
NËPËRMJET HEC “FLET 1”, TË SUBJEKTIT “EU GREEN
ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, nëpërmjet HEC “FLET 1” i privatizuar, të subjektit “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., me vendndodhje: Në përroin e Zhavoreve, degë e Lumit Goska e Madhe, njësia administrative Blerim, Bashkia Fushë Arres, Qarku Shkodër
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

HEC “FLET 1”

Vepra e marrjes, përroi i Zhavoreve (KRGJSH):

- X = 510725
- Y = 4665679
- Z = 710 m.m.n.d

- Qmes-vjet = 0.192 m³/s
- Qllog = 0.5 m³/s
- Qeko = 0.02 m³/s

Godina e Centralit:

- X = 510771
- Y = 4665236
- Z = 642 m.m.n.d

- Fuqia e instaluar N = 520 kW
- Energjia Vjetore E = 1,257,830 kWh/vit.

3. Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

